



Në bazë të nenit 149 pika 1 të Ligjit për Arsim të Lartë, (Fleta Zyrtare e RMV nr. 82/18), nenit 72 të Statutit të Fakulteti i Shkencave Islame- Shkup, në pajtim me Rregulloren për kushtet, kriteret dhe rregullat për regjistrimin e studentëve në studimet e ciklit të dytë në Fakultetin e Shkencave Islame - Shkup, si dhe në bazë të vendimit të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakulteti i Shkencave Islame- Shkup të miratuar në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 21.03.2023 Dekanati i Fakulteti i Shkencave Islame-Shkup, shpall:

KONKURS

për regjistrimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve në Fakultetin e Shkencave Islame - Shkup, në vitin akademik 2023/2024

I. Statusi i studimit dhe numri i studentëve të cilët duhet të pranohen.

Fakultetin e Shkencave Islame- Shkup	Numri i studentëve	Kohëzgjatja e studimeve	Kompensim për semestër
Metodika e mësimdhënies së arsimit fetar	40	Një vjeçare - 60 ECTS	500 euro
Studime të avancuara Islame	40	Një vjeçare - 60 ECTS	500 euro

II. KUSHTET DHE KRITERET PËR REGJISTRIM

a). Të drejtë për konkurrim kanë kandidatët që i plotësojnë këto kushte të përgjithshme:

- ▶ Studimet e ciklit të dytë janë vazhdimësi e studimeve themelore.
- ▶ Në programin studimor të ciklit të II-të mund të regjistrohet personi i cili ka mbaruar programe studimore përkatëse të ciklit të parë dhe i cili i plotëson të gjitha kushtet të cilat parashihen me Ligjin për Arsim të Lartë, Statutin e Fakultetit dhe me Rregulloren si dhe në studime deri diplomike kanë arritur notën mesatare mbi 7,0.
- ▶ Në programin studimor të ciklit të II-të Metodika e mësimdhënies së arsimit fetar mund të regjistrohet personi i cili ka të regjistruar por të papërfunduar studimet e ciklit të dytë Metodika e mësimdhënies së arsimit fetar në institucione tjera të arsimit të lartë në vend ose jashtë tij. Studentët e këtillë regjistrohen në bazë të transferit të lëndëve dhe ngarkesës studimore të fituar në institucionin. Fakulteti sjellë Vendim për pranimin e ngarkesës në bazë të komptabilitetit të programeve studimore.
- ▶ Në ciklin e dytë të studimeve universitare të specializimit profesional mund të regjistrohen kandidatë të cilët kanë të kryer ciklin e parë të studimeve përkatëse në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh, respektivisht 240 kredi.
- ▶ Në ciklin e dytë të studimeve universitare mund të regjistrohen kandidatë të cilët kanë të kryer ciklin e parë të studimeve përkatëse në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh, respektivisht 240 kredi.
- ▶ Në ciklin e dytë të studimeve mund të regjistrohen edhe kandidatë të cilët kanë të kryer ndonjë program tjetër të ngjashëm pasi t'i ketë dhënë provimet diferenciale të Programit studimor Studime Islame respektivisht Metodika e mësimdhënies së arsimit fetar, me suksesin që është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.



- ▶ Fakulteti përcakton se cilat studime janë të përshtatshme për regjistrim në programe të veçanta studimore të ciklit të II-të, si dhe kushtet për regjistrimin e kandidatëve të cilët kanë kryer programe të tjera studimore nga programi në të cilin aplikohet.
- ▶ Kompatibiliteti i ciklit të parë të studimeve universitare për regjistrim në ciklin e dytë të studimeve universitare, si dhe kushtet plotësuese për regjistrim në studimet e ciklit të dytë përcaktohen me aktin e Fakultetit të shpallur në tabelën e shpalljeve të Fakultetit.

b). Shtetas të huaj

Shtetasit e huaj kanë të drejtë regjistrimi në studimet e ciklit të II-të në mënyrë të njëjtë si edhe shtetasit e Republikës së Maqedonisë Veriore.

c). Procedurën për regjistrimin e kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve e udhëheq Komisioni i FSHI-së për realizimin e Konkursit.

- ▶ Rangimin e kandidatëve e bën Komisioni i FSHI-së për realizimin e Konkursit.
- ▶ Lista e rangimit të kandidatëve të pranuar shpallet në tabelën e shpalljeve të Fakultetit dhe në ueb faqen e Fakultetit.
- ▶ Kandidati, ka të drejtë për kundërshtim deri te Komisioni i FSHI-së për realizimin e konkursit, në afat prej 24 orësh nga dita e shpalljes së rezultateve në tabelën e shpalljeve të Fakultetit.
- ▶ Vendimi në lidhje me kundërshtimin sillet në afat prej 24 orësh nga parashtrimi i kundërshtimit.
- ▶ Vendimi i kumtohet parashtruesit të kundërshtimit përmes shpalljes në tabelën e shpalljeve, dhe njëherësh shpallet edhe në ueb faqen e Fakultetit.

Kandidati e ka realizuar të drejtën e regjistrimit nëse gjendet në listën e rangimit deri në numrin e paraparë me konkursin për regjistrim, por, nëse në afatin e paraparë nuk do ta kryej regjistrimin, e humb të drejtën dhe në vend të tij, të drejtën për regjistrim e fiton kandidati i radhës në listën e rangimit.

III. Shpenzimet për studimet e rregullta dhe me korrespondencë në studimet e specializimit i mban vetë studentit me vetëfinancim të studimeve, sipas shumës së përcaktuar me pikën I të këtij konkursi, si taksë shkollimi. Për punimin e temës së magjistraturës respektivisht të specializimit, studentët paguajnë 500 euro, mjete të tjera plotësuese. Mjetet për punimin e së magjistraturës respektivisht të specializimit, i paguajnë para mbrojtjes së punimit të së magjistraturës respektivisht të specializimit. Këshilli i Dekanatit do të sjell vendim për numrin minimal të nevojshëm të studentëve për fillimin me procesin mësimor në programin studimor përkatës.

IV. Afatet për paraqitje

REALIZIMI I KONKURSIT PËR REGJISTRIM TË STUDENTËVE 2023/2024	AFATET E REGJISTRIMIT	
	I-rë	II-të
Aplikimi online (www.fshi.edu.mk)	19 Qershor–05 Shtator 2023	07-19 Shtator 2023
Paraqitja e kandidatëve	01-05 Shtator 2023	12-19 Shtator 2023
Intervista me kandidatë	06 Shtator	20 Shtator
Shpallja e listës preliminare	07 Shtator	21 Shtator
Shpallja e aktvendimit për pranimin e kandidatëve	11 Shtator	22 Shtator
Regjistrimi i kandidatëve	11 - 15.09.2023	25 - 29.09.2023



Sipas nevojës, FSHI do të aplikoj edhe afat plotësues për regjistrim

V. Dokumentet për paraqitje;

Me rastin e paraqitjes për regjistrim në fakultete, kandidatët i dorëzojnë këto dokumente:

1. Formulari i plotësuar nga aplikimi online: www.fshi.edu.mk;
2. Fletëparaqitje për regjistrim
3. Dëshmi për kryerjen e ciklit të parë të studimeve (diplomë ose certifikatë në origjinal, ose fotokopje e vërtetuar në noter);
4. Certifikatë për provimet e dhëna, me nota dhe kredi (në origjinal, ose fotokopje të vërtetuar në noter);
5. Certifikatë të shtetësisë;
6. Dëshmi për njohje të gjuhës së huaj;
7. Rekomandim nga muftinia përkatëse
8. CV e shkurtë.
9. Vërtetim për pagesën e mjeteve: 500 denarë, në emër të shpenzimeve administrative në xhirollogarinë e Fakultetit: HALKBANK AD SHKUP 270070852730133.
10. Dokumente të tjera me kërkesë të njësisë në lidhje me kushtet e regjistrimit

Me rastin e regjistrimit në fakultet, kandidatët i dorëzojnë këto dokumente:

1. Indeks dhe legjitimacion studentit;
2. Tri fotografi (1 në madhësi 6x9 dhe 2 në madhësi 4x5);
3. Fletëparaqitje;
4. Fletëpagesë origjinale, si dëshmi për pagesën e mjeteve për studime në ciklin e dytë të studimeve.
5. vërtetim për pagesën e mjeteve: pagesë e mjeteve për semestrin e parë ose në bazë të semestrit të përcaktuar me Vendim të Fakultetit (nëse studenti regjistrohet me transferë). Pagesat bëhen në xhirollogarinë e Fakultetit: HALKBANK AD SHKUP 270070852730133.

Fletëparaqitja me dokumentet e lartpërmendura dorëzohet në sportelet për çështje studentore në Fakultetin e Shkencave Islame - Shkup, Shërbimi për çështje të studentëve në studimet e ciklit të dytë, Kandidatët, për informata më të hollësishme mund të drejtohen në Shërbimin për çështje studentore të ciklit të dytë të studimeve në Fakultetin e Shkencave Islame - Shkup.

Fakulteti i Shkencave Islame - Shkup